



Titulli i Projektit: Mbështetje për gratë fermere në nevojë të luginës së Valbonës

Zbatuesi: Qendra Blegtoria dhe Zhvillimi Rural (BZHR) www.bzhr.org
Financuesi: Fondacioni Shoqeria e Hapur per Shqiperine

Zona e zbatimit:

Bashkia: Tropoje.

Njesite administrative: Valbone dhe Dragobi. Lugina e Valbones.



Qëllimi I Projektit



Qëllimi i projektit është të përmirësojë të ardhurat e grave fermere në nevojë në Luginën e Valbonës në Tropojë përmes ngritjes së kapaciteteve dhe orientimit të produkteve blegtorale të fermës drejt tregut agro-turistik.



Objektivat



⇒ Të rrisë kapacitetet e grave rurale në Valbonë - Tropojë për prodhimin cilësor të produkteve blegtorale të fermës nëpërmjet zgjerimit të njohurive dhe rigjallërimit të traditave të përpunimit të produkteve të qumështit.

⇒ Të promovojë aftësitë e grave fermere në Valbonë mbi praktikën e mira të mbarështimit, sigurisë dhe cilësinë e përpunimit, llojshmërinë e produkteve të qumështit dhe tregtimin për operatorët turistikë



Aktivitetet



- Mbështetje teknike për 15 gratë fermere në luginen e Valbonës-Tropojë në kontrollin e shëndetit të kafshëve dhe të mjeljes si dhe të përpunimit të produkteve lokale nga specialistë të blegtorisë.
- Organizimi i trajnimeve për:
 - menaxhimin e produkteve të fermës ,
 - higjenën e mjeljes, siguria ushqimore, ,
 - tregtimi e produkteve të fermës, ,
 - barazinë gjinore, fuqizimin ekonomik, agro turizmin ,
- Demonstrim - përgatitja e djathit në fermë mbështetur në traditat lokale tipike të zonës dhe nënprodukteve të tjera të qumështit.
- Sigurimi dhe shpërndarja e mjeteve të përpunimit të qumështit (ene pasterizimi, forma djathi, kova mjeljeje, pajisje përpunuese te qumeshtit);
- Organizimi i një panairi me pjesëmarrjen grave fermere dhe familjarë të tyre për promovimin dhe tregtimin e produkteve të qumështit të menaxhuara nga gratë.
- Botimi i një fletëpalosje për të promovuar produktet e qumështit dhe shpërndarja për të interesuarit.
- Organizohet takimi përmbyllës i projektit për të prezantuar rezultatet e projektit.



Rezultatet e pritshme

- 15 gra dhe familjarët e tyre kanë përmirësuar njohuritë dhe aftësitë praktike mbi mbarështimin e bagëtive, higjienën e qumështit, përpunimin, tregtimin e produkteve të qumështit dhe rrisin të ardhurat.
- Në 15 familje gratë fermere prodhojnë produkte qumështi (djathë, gjizë, gjalpë, salcë kosi etj.) cilësore dhe të sigurta.
- Në 15 familje gratë fermere tregtojnë produktet e tyre dhe bashkëpunojnë me operatorët turistikë.
- Gratë promovojnë produktet blegtorale lokale duke marrë pjesë në një panair lokal.



Faleminderit

